

Në bazë të neneve 125 dhe 131 të Ligjit për arsimin e lartë (Gaz. Zyrtare e RM-së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

KONKURS

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Biomekanika
 - Metodologjia e kërkimeve shkencore me statistikë
2. Një mësimdhënës për lëndën:
 - Volejball
3. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Teoria dhe metodika e edukimit fizik I dhe II
 - Futboll
4. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Teoria e edukimit fizik
 - Filozofia e edukimit fizik
5. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat e edukatës fizike me metodikë I dhe II
 - Skijim
 - Rekreacioni sportiv në shkollë I dhe II
 - Aktivitete avantureske dhe turizëm
6. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Organizimi i edukimit fizik dhe sportit
 - Menaxhimi dhe marketingu i edukimit fizik dhe sportit

FAKULTETI I ADMINISTRATË BIZNESIT

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Sociologjia e arsimit
 - Sociologjia politike

FAKULTETI FILOLOGJIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Historia e librit
 - Civilizimi shqiptar

FAKULTETI FILOZOFIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Psikologjia e punës II
 - Psikologjia e marrëdhënieve mes gjinive
 - Psikologjia e komunikimit dhe të folurit
 - Psikologjia e menaxhimit me resurse njerëzore

FAKULTETI JURIDIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta kushtetuese
 - E drejta e punës

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 125 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Tetovë, 04.05.2018

Universiteti i Tetovës